



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

RAPORTI PËRMBLEDHËS I AKREDITIMIT

PËR SHKOLLËN E MESME PROFESIONALE “HOTELERI-TURIZËM”, TIRANË

QERSHOR 2026

I. BAZA LIGJORE

Procesi i Akreditimit për ofruesit e arsimit dhe formimit profesional mbështetet në Ligjin Nr. 15-2017 datë 16.02.2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Urdhrin nr. 845, datë 3.7.2025 për miratimin e “Rregullores për Standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit Profesional” të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), në rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe në urdhrin e brendshëm të AKAFPK-së me nr. 33, datë 23.07.2025 “Për miratimin e udhëzuesit për procedurat e përzgjedhjes, organizimit dhe etikës profesionale të specialistëve si vlerësues të jashtëm në zbatim të procesit të akreditimit në institucionet ofruese të AFP-së”.

II. KONTEKSTI I OFRUESIT

Histori e shkollës:

Shkolla e Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm”, Tiranë, është një institucion me një histori të gjatë në arsimin dhe formimin profesional në Shqipëri. Ajo është themeluar në vitin 1959 si “Shkolla Teknologjike” dhe, që nga viti 2000, mban emrin aktual. Ndër vite, shkolla ka diversifikuar ofertën e saj arsimore, duke e përshtatur atë me kërkesat e tregut të punës. Në vitin shkollor 1995–1996, në bashkëpunim me Qeverinë Austriake dhe projektin KulturKontakt, u hap drejtimi “Hoteleri-Turizëm”. Drejtimi i Teknologjisë Ushqimore ka qenë një drejtim i konsoliduar dhe i strukturuar që në fillimet e funksionimit të shkollës.

Ndërkohë, kualifikimet profesionale e VET-by-EHL u ofruan për herë të parë në Shqipëri, gjatë vitit shkollor 2024–2025. Aktualisht, shkolla ofron drejtimet arsimore me profilet përkatëse profesionale si, Teknologji Ushqimore, Hoteleri-Turizëm dhe tre kualifikimet VET-by-EHL. Shkolla disponon një infrastrukturë të avancuar, e cila mbështet zhvillimin cilësor të praktikave profesionale.

Shkolla e konsideron bashkëpunimin me biznesin si një komponent thelbësor për garantimin e cilësisë së praktikave profesionale dhe rritjen e mundësive të punësimit pas diplomimit. Për këtë arsye, ajo ka ndërtuar marrëdhënie të forta dhe të qëndrueshme me bizneset, duke zgjeruar çdo vit rrjetin e bashkëpunimit. Një komponent tjetër i rëndësishëm i veprimtarisë së shkollës është gjithashtu bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin lokal. Promovimi i shkollës realizohet përmes pjesëmarrjes në panaire, ekspozita dhe prezantime publike, si edhe nëpërmjet aktiviteteve kulturore, artistike, sportive dhe mjedisore me nxënësit.

Shkolla e Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm” Tiranë, ofron kualifikimet profesionale, sipas niveleve përkatëse në KSHK:

1. “Teknologji Ushqimore”, Niveli II në KSHK, A-II-21
2. “Teknologji e Përpunimit të Brumrave”, Niveli III në KSHK, A1-III-22
3. “Teknologji Ushqimore”, Niveli IV në KSHK, A-IV-23

4. “Hoteleri-Turizëm”, Niveli II në KSHK, G-II-22
5. “Bar-Restorant”, Niveli III në KSHK, G1-III-24
6. “Kuzhinë-Pastricëri” (Pilot), Niveli III në KSHK, G2-III-22
7. “Reception” (Duale), Niveli III në KSHK, G3-III-24
8. “Shërbime në Hotel dhe Restorant”, Niveli III në KSHK, G5-III-24
9. “Kuzhinë” (Duale), Niveli III në KSHK, G8-III-24
10. “Hoteleri-Turizëm, Niveli IV në KSHK, G-IV-25
11. “Kuzhinë”, Niveli III në KSHK, G8-III-24, VET-by-EHL
12. “Hoteleri”, Niveli III në KSHK, G9-III-24, VET-by-EHL
13. “Shërbime Ushqimi dhe Pije”, Niveli III në KSHK, G10-III-24, VET-by-EHL

III. PËRMBLEDHJA E PROCESIT

Ofruesi Publik i AFP-së, Shkolla e Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm” Tiranë, depozitoi kërkesën për akreditim pranë AKAFPK-së me nr. 235 prot. datë 14.7.2025, me lëndë “Kërkesë për Akreditim, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 273 prot., më datë 28.7.2025. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në zbatim të Urdhrit nr. 845/2025 të MEKI nisi procesin e Akreditimit duke ngritur dhe konsoliduar grupin e vlerësuesve të jashtëm (GVJ), përmes një procedure të miratuar më parë.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të akreditimit të Shkollës së Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm”, Tiranë me qëllim sigurimin e një analize të plotë dhe të saktë ka përdorur metoda dhe instrumente të ndryshme, të renditura si më poshtë:

1. **Studimi i dosjes** së vetëvlerësimit dhe dokumentacionit përkatës, përfshirë aktet rregullatore, planet institucionale, programet e formimit, evidencat e vlerësimit, raportet e monitorimit dhe dokumentacionin mbështetës për standardet e akreditimit;
2. **Takime të përbashkëta** me drejtuesit e institucionit, stafin administrativ dhe mësimdhënës me qëllim sqarimin dhe verifikimin e informacionit të paraqitur në dokumentacion;
3. **Zhvillimi i intervistave** të strukturuar dhe gjysmë të strukturuar me përfaqësues të strukturave drejtuese, mësimdhënës, nxënës dhe aktorë të tjerë të përfshirë;
4. **Përdorimi i pyetësorëve dhe analizimi i tyre** si instrument vlerësimi, për mbledhjen dhe përpunimin e mendimeve, perceptimeve dhe nivelit të kënaqësisë së palëve të interesuara lidhur me cilësinë e ofrimit të shërbimit arsimor dhe formues;
5. **Përpunimi dhe analiza e të dhënave të mbledhura**, përmes krahasimit të gjetjeve nga burime të ndryshme, me synim sigurimin e koherencës dhe triangulimit të informacionit;
6. **Vëzhgimi i drejtpërdrejtë në IoAFP**: Vëzhgim i ambienteve mësimore dhe të përbashkëta, pajisjeve, laboratorëve dhe infrastrukturës mbështetëse, për të vlerësuar përputhshmërinë me standardet e sigurisë, funksionalitetit dhe cilësisë së mësimdhënies;

7. **Ndarja e punës në grupin e vlerësimit**, duke përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e secilit anëtar, në funksion të mbulimit të të gjitha fushave dhe standardeve të vlerësimit.

Organizimi i punës.

Grupi i vlerësimit të jashtëm, i përbërë nga tre anëtarë, organizoi punën me ndarje të qartë të detyrave për grumbullimin, analizën dhe përpunimin e dokumentacionit. Diskutimet për gjetjet dhe rekomandimet u zhvilluan në mënyrë bashkëpunuese duke siguruar vendimmarrje të përbashkët. Koordinimi u realizua duke kombinuar bisedat fizike me komunikimin online, dhe përmes kontaktit të vazhdueshëm me koordinatorin e procesit pranë AKAFPK për çdo çështje që kërkonte sqarim. Ky organizim siguroi një proces efikas dhe një analizë të plotë të rezultateve.

Mbyllja e procesit.

Në përfundim, metodologjia e ndjekur ka mundësuar një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të balancuar të performancës së ofruesit të AFP-së, duke siguruar bazën e nevojshme faktike për konkluzionet, vlerësimet dhe rekomandimet e paraqitura në raport.

IV. GJETJET PËR 5 FUSHAT E CILËSISË

Fusha 1 Menaxhimi.

Shkolla e Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm”, Tiranë bashkëpunon me përfaqësuesit e grupeve të interesit. Organet e detyrueshme funksionojnë në bazë të ligjit. Plan i Afatmesëm dhe Plan i Vjetor janë të miratuar. Ofruesi i AFP-së përdor metodologjitë e nevojshme. Sistemi i menaxhimit të dokumenteve dhe menaxhimit të të dhënave funksionon. Ofruesi i AFP-së respekton legjislacionin. Njësia e Zhvillimit është funksionale dhe dokumenton aktivitetin e saj. Ofruesi i AFP-së ka realizuar vetëvlerësimin dhe ka hartuar planin e përmirësimit të cilësisë. Protokollimi i dokumentacionit duhet të bëhet në përputhje me kuadrin ligjor të arkivave.

Fusha 2 Marrëdhënia dhe bashkëpunimi.

Shkolla e Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm”, Tiranë komunikon dhe bashkëpunon me komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile, por nuk evidentohet qartë prezenca e shoqërisë civile në planet e zhvillimit. Ka ambiente të specializuara për aftësimin praktik. Në të ardhmen duhet të identifikojë qartë bashkëpunimin me shoqërinë civile në Planin Afatmesëm dhe Planin Vjetor.

Fusha 3 Kurrikula e zbatuar.

Mësuesit dhe instruktorët e shkollës e planifikojnë aftësimin praktik në kohë dhe me burimet e nevojshme për të zhvilluar aftësitë praktike për të gjithë nxënësit e regjistruar në kualifikimet përkatëse. Kurrikula bazohet në standardet profesionale dhe në standardet e kualifikimeve në fuqi. Garantohej zhvillimi i kompetencave kyçe dhe kompetencave profesionale. Në shumicën

e mjediseve për zhvillimin e lëndëve teorike dhe praktike ka laboratorë të cilët janë të pajisur me pajisje të posaçme. Mjediset e shkollës ofrojnë mundësi të mira për zhvillimin e procesit normal mësimor për lëndët teorike dhe praktikat profesionale. Ekipet lëndore janë të organizuara mirë për planifikimin dhe realizimin e mësimi. Drejtoria siguron pajisjen me tekstet shkollore dhe materialet e tjera ndihmëse për mësimdhënien, të cilat nevojiten për të zbatuar mësimet e planifikuara në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe me kërkesat e standardeve profesionale dhe standardeve të kualifikimit profesional.

Fusha 4 Mësimdhënia dhe të nxënit.

Mësuesit dhe instruktorët realizojnë planifikimin ditor sipas kriterëve dhe udhëzimeve. Për çdo njësi mësimore përcaktohen objektivat dhe rezultatet e të nxënit, në pajtim me kurrikulën e planifikuar. Procesi i mësimdhënies dhe i mësimnxënies garanton arritjen e rezultateve të planifikuara të të nxënit dhe zhvillimin e kompetencave kyçe.

Fusha 5 Vlerësimi.

Mësuesit përdorin metodologjitë dhe instrumentet e planifikuara për vlerësimin e vazhduar dhe përfundimtar. Metodologjitë dhe instrumentet përdoren në procesin mësimor dhe mbulojnë rezultatet e të nxënit dhe kompetencat e përcaktuara nga standardet. Të dhënat dhe evidencat mbi rezultatet e vlerësimit të nxënësve, progresin dhe performancën e tyre mbledhen dhe regjistrohen rregullisht. Planifikimi dhe organizimi i provimeve të niveleve dhe të maturës shtetërore realizohet sipas legjislacionit në fuqi. Përfaqësuesit e biznesit janë shumë bashkëpunues, përfshihen në organizimin e praktikave profesionale, në hartimin e metodologjive dhe instrumenteve të vlerësimit, kryesisht për vlerësimin e rezultateve të të nxënit me bazë punën. Drejtoria e shkollës merr masa për sigurimin e mjediseve, infrastrukturës dhe burimeve njerëzore dhe materiale për organizimin e provimeve.

V. REKOMANDIMET E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR

FUSHA 1. MENAXHIMI

- **Rekomandim nr. 1 (Kriter plotësues 1.1.1.2)**
Rekomandohet shtimi i publikimit të informacioneve rreth veprimtarisë dhe kontributit të përfaqësuesve të grupeve të interesit në ambientet e Ofruesit të AFP-së dhe rrjetet sociale. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga 2026 e në vijim.
- **Rekomandim nr. 2 (Kriter bazë 1.1.1.3)**
Rekomandohet hartimi i një plani të shpërndarjes së informacionit tek Grupet e Interesit. Në varësi të periudhave të hartohet edhe relacioni përkatës ku të përshkruhet shkurtimisht shpërndarja e informacionit tek grupet e interesit. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga 2026 e në vijim.

- **Rekomandim nr. 3 (Kriter bazë 1.1.2.1)**
Rekomandohet evidentimi dhe dokumentimi i qartë i mbledhjes së informacionit nga Grupet e Interesit, duke filluar nga viti shkollor 2026-2027.
- **Rekomandim nr. 4 (Kriter bazë 1.1.2.1)**
Rekomandohet përditësimi periodik i Rregullores së Institucionit me qëllim reflektimin e ndryshimeve të reja organizative dhe ligjore. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga Shtatori 2026 e në vijim.
- **Rekomandim nr. 5 (Kriter bazë 1.1.2.2)**
Rekomandohet që shkolla të marrë masa për të pasqyruar të gjitha rezultatet e funksionimit të organeve zyrtare të krijuara me ligj në planet dhe programet zyrtare. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga Shtatori 2026 e në vijim.
- **Rekomandim nr. 6 (Kriter bazë 1.2.1.5)**
Rekomandohet që objektivat e Planit Afatmesëm tu referohen specifikisht të gjitha llojeve dhe niveleve të kualifikimeve të ofruara. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga viti shkollor 2026-2027.
- **Rekomandim Nr. 7 (Kriter bazë 1.2.2.2)**
Brenda vitit shkollor 2025-2026 e në vazhdim rekomandohet integrimi i objektivave dhe aktiviteteve në planin vjetor sipas parashikimeve në planin afatmesëm për vitin përkatës.
- **Rekomandim nr. 8 (Kriter bazë 1.2.2.3)**
Rekomandohet që Objektivat e Planit Vjetor tu referohen specifikisht të gjitha llojeve dhe niveleve të kualifikimeve të ofruara. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga Shtatori 2026 e në vijim.
- **Rekomandim nr. 9 (Kriteret bazë 1.3.1.1, 1.1.2.1; 1.1.2.2; 1.5.1.2; 2.2.2.3)**
Konstatim: Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të shkollës është vënë re se shumë shkresa nuk janë në përputhje me kuadrin ligjor për Arkivat pasi janë pa numër protokolli dhe pa data; e njëjta procedurë protokollohet me disa numra protokolli, dhe jo me fraksione; numrat e protokollit dhe datat janë plotësuar me shkrim dore mbi dokumente.

Rekomandohet trajnimi i punonjësës së arkiv/protokollit për zbatimin korrekt të procedurave të protokollimit dhe administrimit të dokumentacionit. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga viti shkollor 2025-2026 e në vijim.
- **Rekomandim nr. 10 (Kriter plotësues 1.5.1.4)**
Rekomandohet unifikimi i formateve të vlerësimit të stafit. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga viti 2026 e në vijim.

- **Rekomandim nr. 11** (Kriter plotësues 1.5.1.4)
Rekomandohet njohja paraprake e stafit me kriteret e vlerësimit, si dhe nënshkrimi i tyre nga të gjitha palët: vlerësuesit, mësimdhënësit dhe drejtuesi i ofruesit të AFP-së. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga viti 2026 e në vijim.
- **Rekomandim nr.12 (Kriteret bazë 1.6.3.2 ; 1.6.4.2)**
Rekomandohet vënia në funksionim e ashensorit brenda 6 mujorit të parë të vitit 2026.
- **Rekomandim nr. 13** (Kriter plotësues 1.6.3.7)
Hapësira aktuale e bibliotekës është e pamjaftueshme. Rekomandohet që në vijim të merren masa për zgjerimin e kapacitetit të saj.
- **Rekomandim nr.14** (Kriter plotësues 1.6.3.7)
Rekomandohet pasurimi i fondit me libra profesionalë dhe rritja e frekuentimit të bibliotekës nga nxënës dhe mësues. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga Shtatori 2026 e në vijim.
- **Rekomandim nr. 15 (Kriter bazë 1.6.4.1: 1.6.4.2)**
Rekomandohet krijimi i një Dosjeje të veçantë me kopje të të gjitha autorizimeve të shëndetit publik dhe të sigurisë të lëshuara nga autoritetet kompetente, për mjediset e praktikës profesionale që ofrohen në partneritet me biznesin. Ky rekomandim të zbatohet nga viti 2026 e në vijim.
- **Rekomandim nr.16 (Kriter bazë 1.6.4.2)**
Rekomandohet që Ofruesi i AFP-së të ndërmarrë masa për funksionimin e plotë dhe efikas të sistemit të ngrohjes në të gjitha ambientet që përdoren për procesin mësimor. Ky rekomandim të zbatohet nga viti 2026 e në vijim.
- **Rekomandim nr. 17** (Kriter plotësues 1.6.5.5)
Rekomandohet rritja e numrit të stafit të trajnuar për dhënien e ndihmës së parë, në përputhje me numrin e nxënësve. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga Shtatori 2026 e në vijim.
- **Rekomandim nr. 18** (Kriter plotësues 1.6.5.5)
Rekomandohet firmosja e një Marrëveshje Bashkëpunimi midis Ofruesit të AFP-së dhe Qendrës Shëndetësore më të afërt për të ofruar shërbimin e nevojshëm në rastet e emergjencës. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga 2026 dhe në vijim.
- **Rekomandim nr. 19 (Kriter bazë 1.7.1.2)**
Rekomandohet që Organet Drejtuese të përmendin shprehimisht në çdo vendim të marrë procedurat dhe afatet e ankimit. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga 2026 e në vijim.

FUSHA 2. MARRËDHËNIA DHE BASHKËPUNIMI

- **Rekomandim nr. 20** (Kriter plotësues i papërmbushur 2.2.1.3)
Rekomandohet që Shkolla të dokumentoj mbledhjen e informacionit mbi shkallën e kënaqësisë nëpërmjet anketimeve dhe pyetësorëve. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga 2026 e në vijim.
- **Rekomandim nr. 21 (Kriteret bazë 2.2.1.4; 2.2.2.4 2.2.2.3; Kriteret plotësuese 4.1.2.3; 4.1.2.4)**
Rekomandohet që, nga muaji Maj 2026 e në vijim, të protokollohen me numër të veçantë Akt-marrëveshjet e Bashkëpunimit dhe Kontratat e praktikës profesionale me bizneset, në përputhje me kuadrin ligjor për arkivat.
- **Rekomandim nr. 22 (Kriteret bazë 2.3.1.1, 2.3.1.2)**
Rekomandohet rritja e bashkëpunimit me Shoqërinë Civile dhe përshkrimi i qartë i këtij bashkëpunimi dhe rolit të tij, në Planin Afatmesëm dhe Planin Vjetor. Rekomandimi duhet të fillojë të zbatohet qysh në vitin 2026, duke rishikuar Planin Afatmesëm 2023-2027 dhe Planin Vjetor 2025-2026.
- **Rekomandim nr. 23** (Kriteret plotësuese të papërmbushura 2.3.1.5; 2.3.1.4,)
Rekomandohet Evdidentimi i qartë i bashkëpunimit me organizata të specializuara të Shoqërisë Civile për të rritur nivelin e regjistrimit dhe të frekuentimit. Rekomandimi duhet të fillojë të zbatohet nga viti shkollor 2026-2027 dhe në vijim.
- **Rekomandim nr. 24 (Kriteret bazë 2.4.1.1; 2.4.2.1)**
Rekomandohet pasqyrimi i plotë dhe i detajuar i të gjithë partnerëve, institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare të AFP-së, veçanërisht ato nga të cilat ofruesi i AFP-së regjistron ose tërheq nxënës, si dhe ato ku të diplomuarit e AFP-së mund të vijnë arsimimin e tyre, donatorë, ose grupe të tjera të interesit, në Planin Afatmesëm dhe Planin Vjetor. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga Shtatori 2026 e në vijim.

FUSHA 3. KURRIKULA E ZBATUAR.

- **Rekomandim nr. 25** (Kriter plotësues 3.2.1.1)
Rekomandohet që, duke filluar nga viti 2026 mësimdhënësit të përdorin për mësimdhënie një set materialesh të përditësuara për çdo lëndë.

FUSHA 4: MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT

- **Rekomandim nr. 26** (Kriter plotësues i papërmbushur 4.4.1.2,)
Rekomandohet që shkolla të realizojë dhe të dokumentojë veprimtarit mbështetëse përmirësuese, të bazuara në rezultatet e vlerësimit të vazhduar dhe atij përfundimtar. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga Shtatori 2026 e në vijim.

- **Rekomandim nr. 27 (Kriter bazë 4.5.1.1)**

Rekomandohet që shkolla të realizojë instrumente vlerësimi, si pyetësorë dhe intervista me nxënësit me nevoja të veçanta, për të vlerësuar aksesin në mjedise dhe mbështetjen e përshtatshme për ta. Rekomandimi duhet të zbatohet nga viti shkollor aktual dhe në vijim.

FUSHA 5: VLERËSIMI

- **Rekomandim Nr. 28 (kriter bazë 5.1.1.4)**

Rekomandohet që mësimmshënësit të dokumentojnë vazhdimisht aktivitetet dhe rezultatet e vlerësimit individual dhe të njëri-tjetrit. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga Shtatori 2026 e në vijim.

- **Rekomandim Nr. 29** (kriter plotësues i papërmbushur 5.1.3.1)

Rekomandohet që shkolla të informojë nxënësit dhe prindërit për kriteret, metodat, instrumentet dhe afatet kohore të vlerësimit të vazhduar dhe përfundimtar, si dhe të dokumentojë komunikimin me ta. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga viti shkollor aktual dhe në vijim.

- **Rekomandim Nr. 30** (kriter plotësues i papërmbushur 5.1.4.1)

Rekomandohet që shkolla të konsultohen me përfaqësues të bizneseve për hartimin e metodologjive dhe instrumenteve të vlerësimit, kryesisht për vlerësimin e rezultateve të të nxënit me bazë punën. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga Shtatori 2026 e në vijim.

- **Rekomandim nr. 31** (Kriter plotësues i papërmbushur 5.1.4.3)

Rekomandohet forcimi i mekanizmave të dokumentimit, komunikimit dhe informimit të punëdhënësve dhe përfaqësuesve të biznesit për rezultatet e vlerësimit përfundimtar, me qëllim rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë së këtij procesi. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet nga Qershori 2026 e në vijim.

VI. VENDIMI PËR AKREDITIM

Në bazë të raportit të akreditimit dhe propozimit të AKAFPK-së, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit mori vendimin për **akreditim** për ofruesin publik të AFP-së, Shkolla e Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm”, Tiranë me Vendim nr. 240, datë 02.06.2026.

AKAFPK ka lëshuar certifikatën e akreditimit, me nr. serie 23, data 19.06.2026, me afat vlefshmërie deri më 01.06.2030.